VENDIM
Nr.198, datë 14.4.2004

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E AKADEMISË DIPLOMATIKE PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Akademisë Diplomatike, në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Akademia Diplomatike është qendra e trajnimit, kualifikimit dhe rikualifikimit të të gjithë punonjësve të shërbimit me jashtë, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe janë pjesë e personelit diplomatik.

3. Akademia Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të hartojë programet arsimore të trajnimit, kualifikimit dhe rikualifikimit të punonjësve, që përbëjnë personelin diplomatik, si dhe të drejtojë, të bashkërendojë e të administrojë kurset e përgatitjes së diplomatëve.

4. Programi arsimor i trajnimeve, kualifikimeve dhe rikualifikimeve të Akademisë Diplomatike miratohet nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe mbarëvajtja e tij kontrollohet nga këshilli drejtues.

5. Akademia Diplomatike ka strukturë funksionale të drejtuar nga drejtori i Akademisë Diplomatike, personeli i së cilës gëzon statusin, gradën dhe trajtimin financiar të punonjësve të shërbimit me jashtë.

6. Drejtori dhe personeli i Akademisë Diplomatike emërohen në përputhje me ligjin nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

7. Pranë Akademisë Diplomatike veprojnë këshilli drejtues dhe këshilli shkencor.

a) Këshilli drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, duke përfshirë edhe drejtorin e Akademisë. Këshilli kryesohet nga Ministri i Punëve të Jashtme. Këshilli drejtues harton programin vjetor të veprimtarisë së Akademisë, afatet kohore të kurseve dhe lektorët.

b) Këshilli shkencor përbëhet nga 7 anëtarë. Në të mund të përfshihen edhe specialistë të huaj, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Këshilli shkencor bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në kurs, analizon nevojat formuese, projekton kursin, siguron burimet njerëzore dhe materiale, bën programimin didaktik dhe realizimin e kursit.

8. Anëtarët e këshillit drejtues dhe të këshillit shkencor emërohen nga Ministri i Punëve të Jashtme, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

9. Veprimtaria e Akademisë Diplomatike mbështetet në rregulloren e posaçme, të hartuar nga këshilli shkencor e nga këshilli drejtues dhe të miratuar nga Ministri i Punëve të Jashtme, në përputhje me legjislacionin përkatës, që rregullon veprimtarinë e institucioneve të kësaj natyre në Republikën e Shqipërisë.

10. Personeli i Akademisë Diplomatike përbëhet nga një staf prej 4 personash: drejtori i Akademisë, sekretari shkencor (shef sektori) dhe dy specialistë.

11. Efektet financiare, në shumën 3 919 626 (tre milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë, për pagat e personelit të Akademisë Diplomatike, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

12. Ngarkohet Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano